



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kacanik  
Municipal of Kacanik

01Nr.060/01-14024/25  
Kaçanik, 30.06.2025

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **VI (gjashtë)** e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2025 (Legjislatura e shtatë), mbajtur me 30.06.2025. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës fillimisht ishin 24 anëtarë, pas votimit të pikës 1, arriti Betim Shala, ndërkaq gjatë diskutimit të pikës 2, Florina Lika-Vishi. Në mbledhje mungoj me arsye, Agim Çaka, kështu që pjesëmarrës të këtij takimi ishin 26 anëtarë.

Nga Ekzekutiviteti i Komunës në mbledhje morën pjesë: Nënkryetari i Komunës-Sabedin Vishi, Drejtorët e drejtorive: Bahri Selimi-DBF, Ramadush Osmani-DSHPE, Qamil Stagova-DUKMM, Suhad Dullovi- DBPZHR, Pranvera Loku-Zharku-DZHET, Sali Malsiu-DSHMS, Hafize Sallahi-DKRS, ndërkaq nga zyrtarët në kuadër të detyrave të punës ishin: Fatlume Guri-Selimi- Zyra e Informimit, Bejtulla Dalloshi- Zyra e IT, Mavije Murseli-Zyra e Kryesuesit, Makfire Malsiu-Zyra e KK.

Mbledhja monitorohet përmes Teleprezencës nga Vjosa Ahmetaj- zyrtare në MAPL. Mbledhja ka transmetim të drejtpërdrejtë.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli- Kryesues i Kuvendit  
Procesmbajtës, Makfire Malsiu - Zyrtare e lartë për punë të KK.

**Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli:** Se pari iu përshëndes të gjithëve, iu uroj mirëseardhje, konstatoj kuorumin, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, prezentë janë 24 për momentin, Florina Lika-Vishi me ka njoftuar se vonohet pak, ndërkaq me arsye mungon Agim Çaka, për shkak se ka rast vdekje, i shprehim ngushëllime në emër të KK për vdekjen e nënës së tij. Në vazhdim e hapi mbledhjen e gjashtë (6) të rregullt të KK për vitin 2025, data 30 qershor, me këtë:

### REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës (KABK) së Kaçanikut 2026-2028;
3. Propozim Rregullorë për transportin rrugor në territorin e komunës së Kaçanikut;
4. Propozim Rregullorë për transparencë e komunës së Kaçanikut;
5. Plani i veprimit për transparencë e komunës së Kaçanikut;
6. Propozim Vendimi për rialokimin e mjeteve buxhetore sipas buxhetit të vitit 2025;
7. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik "MUJA" O.P;
8. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik "JLG CONSTRUCTION" SH.P.K;

9. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik N.P “X- PLAST”;
10. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik “NTP GREEN PRODUCT”;
11. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik “XHEMILE VISHI.B.I”;
12. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik N.SH.T ”LYPETENI”;
13. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik Fatmir Gashi B.I.;
14. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik “ERA PLAST SH. P. K”.

Lidhur me rendin e punës, e hapi diskutimin: Për diskutimin nuk u paraqit kush, atëherë rendi i punës u shtrua në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Prezent 24. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës

### **Aprovoj**

#### **Rendin e punës prej 14 pikave.**

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

**Kryesuesi i Kuvendit:** A ka kush ndonjë vërejtje në procesverbal?

**z. Agim Mani:** Në emër të LVV konfirmoj se nuk marrim pjesë në votim, pasi nuk kemi qenë pjesë e procesit.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Procesverbalin e mbledhjes së kaluar të KK e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me 16 votë Për, Kundër votë nuk pati, Abstenim Raif Kasa. Nuk votuan 7 anëtarë-LVV. Prezent 24. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës

### **Aprovoj**

**Procesverbalin e mbledhjes së V (pestë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës, të datës 30.05.2025/Lënda: 01Nr.60/01-11317/25.**

Pas aprovimit të Procesverbalit, arriti në mbledhje, Betim Shala, prezentë janë 25.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Konstatoj me kaluar në pozicionin e pyetjeve dhe kërkesave:

#### **Pyetje dhe Kërkesa**

**znj. Ardita Rrahmani:** 1. Ditëve të fundit, qytetarët e Kaçanikut kanë filluar me të kenë probleme me mungesën e ujit të pijes. Referuar takimit me shefin rajonal të ujësjellësit, i cili u zotuan se në qershor do të përfundojnë punimet e shtimit të kapacitetit të ujit. Për cilin qershor është fjala, se problemi i ujit të pijes ka filluar me ndodhë qysh tani, ndërkaq nuk po mundemi me menduar se çka ka me ndodhë në muajin korrik dhe gusht me ujë?

2. Çka po ndodhë me rrugën: Stagovë-Runjevë, a do të bëhet asfaltimi i saj para zgjedhjeve lokale, apo veç është hapur traseja e saj, nëse po, sa do të jetë gjerësia e asaj rruge?

3. Aksidentet në rrethinë të Kaçanikut dhe jo vetëm, dita ditës po rritën, krejt kjo si pasojë e mungesës së sinjalistikës në lokalitete të Kaçanikut. Po e adresoj si kërkesë vendosjen e sinjalistikës, po ashtu ri theksoj kërkesën për vendosjen e policëve të shtrirë në rrugën “Qamil Ilazi” drejtuar “Besnik Begunca”?

4. Para 1 ore është bërë publike një kërkesë drejtuar komunës nga banorët e zonës së rrugës Dubravë-Provoli-Tushaj, për me marrë masa urgjente në udhëkryqin e kësaj rruge, ku po ndodhin aksidente çdo ditë. Ky udhëkryq paraqet rrezik serioz për jetën e qytetarëve, për shkak se po ndodhin aksidente pothuajse çdo ditë, për shkak të mungesës së një zgjidhje infrastrukture që e bënë me të sigurt qarkullimin. Banorët e asaj zone, kërkojnë nga komuna të shqyrtojnë gjendjen në terren sa me shpejt, të vendoset sinjalizim i duhur dhe masat e sigurisë dhe të parasheh ndërtimin e një rreth rrotullimi apo zgjidhje tjetër teknike, për me parandaluar me tej rrezikun. Jeta e qytetarëve nuk duhet të vihet me në rrezik, për shkak të mos reagimit institucional. Shpresoj që kjo kërkesë e asaj zone të merret sa me shpejt parasysh dhe të intervenohet në atë pjesë.

5. Kam një pyetje nga banorët e rrugës “Reshat Shehu”, kanë ngritur shqetësimin për gypat e plastikës të vendosura që 2 vite me parë, që i kanë zëvendësuar gypat e azbest betonit, por kyçja në ata gypa nuk është bërë ende. Kur do të bëhet kyçja e ujit në ata gypa?

**znj. Arta Avdiu:** I kam 2 kërkesa për DSHPE:

1. Paraqes një shqetësim serioz lidhur me gjendjen e sheshit në qytet. Edhe pse është hapësirë publike është e trumbetuar, kanë filluar të paraqitën probleme infrastrukture. Në një pjesë të sheshit, janë shfaqur dëmtime në infrastrukturë, ku kanë filluar edhe rrjedhja e ujit, e cila jo vetëm që dëmton estetikën e hapësirës, por paraqet rrezik të drejtpërdrejtë të qytetarëve për shëndetin e qytetarëve, e në veçanti për fëmijët që luajnë aty çdo ditë. Një gjendje e tillë është e papranueshme, për një projekt të ri që janë investuar mjete publike. Kërkoj të bëhet ndërhyrje e menjëhershme për sanimin e gjendjes së krijuar?

2. Kam një kërkesë nga banorët e rrugës “Idriz Seferi” dhe bizneset që operojnë për rregullimin e kubzave në atë rrugë, se kubëzat janë dëmtuar, aty ka filluar të grumbullohet uji. Kërkoj nga DSHPE të merren veprime të nevojshme për sanimin e gjendjes së krijuar?

**z. Naim Beça:** Kam shumë kërkesa nga komunitetet ku jetojmë ne, po i specifikoj disa prej tyre:

1. Të shkolla fillore duhet të vendosen me urgjencë të madhe pengesat-policët e shtrirë.

2. A ka afat se kur do të rregullohet parku, se po me duket jo logjike me u rregulluar në kohën para zgjedhjeve? Nëse ka mundësi me u rregulluar me herët parku.

3. Problemi i ujit të pijes: Të gjithë banorët e Kaçanikut janë të brengosur për çështjen e ujit të pijes në Kaçanik dhe me kanë adresuar shumë pyetje për këtë çështje. Të premtën nuk ka pasur ujë në Begracë, kurse në fshatrat e Vitisë që e marrin ujin prej Kaçanikut, kanë pasur ujë të pijes. Aty duhet me u marrë një aksion, e jo grumbullimi i ujit me bërë në fshatra të Vitisë me ujin e Kaçanikut, e Begraca e Kaçaniku i Vjetër, mos me pasur ujë të pijes.

Pyetja ime është: A është testuar siç kemi biseduar me herët dhe siç jemi kuptuar, uji të fabrika, me dërguar në laborator për testim dhe a keni marrë përgjigje prej organeve kompetente për cilësinë e ujit?

**znj. Ernesta Krasniqi:** Kërkesat tona po përsëriten vazhdimisht, për arsye se nuk po marrim përgjigje. Edhe unë kam kërkesë për gjendjen e mjerueshme të rrugës të shtruar me kalldrëm, secili që kalon atypari, shihet gjendja katastrofale e rrugës, dëmtime të vazhdueshme e gropa gjithandej. Kërkoj të merrni veprime të nevojshme që ajo rrugë të shtrohet mirë, duke ditur se ajo rrugë është shtruar disa herë, në mënyrë që mos të kthehemi sërish të i njëjti problem?

2. Kohëve të fundit kemi vërejtur grumbull mbeturinash të shpërndarë vend e pavend. Kjo gjendje po krijon papastërti dhe rrezik për shëndetin e qytetarëve dhe pamje të shëmtuar për qytetin tonë. A mundeni të na informoni se a ka inspektor të terrenit për kontroll të rregullt, sa gjoba janë shqiptuar për këto parregullsi që po ndodhin në qytetin tonë?

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Sot jam detyruar të ngritem në këmbë për heshtjen e ekzekutivit të komunës për tre mbledhje radhazi për mungesë të përgjigjes për të njëjtën pyetje, këtu shihet se nuk ka transparencë. Detyrohem për herë të katërt të bëjë pyetje: A ka komuna e Kaçanikut Harta zonale? Pyetja është shumë e saktë dhe e shkurtër, përgjigja të jepet me shkrim.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Harta zonale nuk ka, megjithatë, përgjigjen e jep drejtori me shkrim drejtori i drejtorisë.

**z. Burim Shehu:** Janë bërë 40 ditë prej kohës kur me keni kthyer një përgjigje për Lagjen e Re, për rregullimin e asfaltit të rrugës, që është shumë i dëmtuar, ndërkaq ende nuk kanë filluar punimet. A ka diçka në këtë drejtim se kur do të fillojnë punimet e sanimit të gjendjes së kësaj rruge?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Pyetje dhe kërkesat tjera nuk ka, përgjigjet i merrni në mbledhjen vijuese të KK. Kalojmë në pikën e dytë:

## 2. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës (KABK) së Kaçanikut 2026-2028;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Materialin e keni marrë, kjo çështje është debatuar edhe në KPF, fillimisht fjalën ia kalojmë drejtorit të DBF, Bahri Selimi:

**z. Bahri Selimi:** Nuk po e zgjati shumë se materialin e keni marrë. Për dallim prej materialit, e kemi bërë një ndryshim të vogël të kategoritë ekonomike mallrat dhe shërbimet, janë zvogëluar për 100 mijë euro, i kemi rritur subvencionet dhe transferet. E kemi diskutuar me ekzekutivin, për vitin vijues kemi vendosur që lehonat të subvencionohen me nga 100 euro, ndërsa për rastet tjera që munden me ndodhur, parashikimi është deri në 500 euro.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

**z. Agim Mani:** KBAK është një dokument strategjik jashtëzakonisht i rëndësishëm, që orienton planifikimin e zhvillimor dhe financiar për tre vitet vijuese. Ky dokument duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe në përputhje të plotë me prioritetet që komuna i ka shpallë si pjesë të vizionit të saj. Dokumenti që është paraqitur për vitin 2026, nuk i përmbush këto kritere. Mospërputhja me prioritetet komunale në strategjinë e komunës thuhet, bujqësia, turizmi dhe zhvillimi ekonomik janë fushat me prioritet, mirëpo në këtë dokument nuk shihet një veprim i tillë. Për bujqësinë në vitin 2026 janë ndarë vetëm 50 mijë euro, ndërkaq 150 mijë euro për 2027 dhe 2028. Kjo është shumë e ulët e mjeteve për një sektor që shpallet si prioritet. Po ashtu fermerët që shfrytëzojnë kullosën në zonën e lubotenit, ata që merren me blegtori, nuk janë përfshirë fare, as mjete as kod buxhetor, për rregullimin e rrugës për luboten, që kishin me pasur një qasje me të lehtë për zhvillimin e blegtorisë, për kundër se kjo ka qenë kërkesë e vazhdueshme në debatet publike edhe në vitet e kaluara, por asnjëherë nuk është marrë parasysh. Për zhvillim ekonomik janë ndarë 25 mijë euro për vitin 2026, pa ndonjë projekt konkret, që do të gjeneronte punësim apo të ardhura për qytetarët, përpos ndërtimin e kioskave në sheshin e qytetit. Turizmi ndonëse përmendet si prioritet, është i anashkaluar me këtë dokument, i keni paraparë vetëm 50 mijë euro për zhvillimin e turizmit. Shqetësim tjetër është rënia e IK. Në vitin e kaluar IK janë mbi 3.4 milion euro dhe me bartjen e mjeteve të HVK nga vitet paraprake, ka arritur shumën 4.4 milion, ndërsa për vitin 2026, IK janë 2.8 milion, për 600 mijë euro me pak, apo me mjetet e bartura nga vitet paraprake për 1500 me pak. Kjo qasje e juaj, është vazhdimësi e një politike regresive, që në vend që të ngritën IK, ju i zvogëlioni. Ky është rezultat i mos angazhimit dhe politikave të dobëta lokale, dhe si pasojë e tyre, ka ra numri i banorëve që kanë migruar në vende tjera përreth, dhe kjo ndikon edhe në zvogëlimin e buxhetit. Ne kërkojmë që deri me miratimin përfundimtar të buxhetit të vitit 2026-2028, të ri shikohet dhe të orientohet buxheti në sektorët që ndikojnë drejtpërdrejtë në mirëqenie të qytetarëve, si bujqësi, zhvillim ekonomik dhe turizëm. KBAK të orientuar në këtë formë, ne nuk do të përkrahim.

**znj. Ardita Rrahmani:** Kam një pyetje drejtor që e kam ngritur edhe në KPF: A është bërë ndryshimi në KBAK, ku është shënuar që, QMF në komunën e Kaçanikut janë jashtë funksionit? Është thënë se ka qenë gabim teknik, ndërkaq kritika ime ka qenë, nëse është gabim teknik, lë të përmirësohet gabimi.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Në KPF e cekëm se Kaçaniku ka nevojë për ngritjen e kapaciteteve të shërbimeve të laboratorit. Ne vazhdimisht kemi bërë kërkesë, por nuk është marrë parasysh kërkesa jonë. Unë po e shoh se janë ndara të shëndetësia 35 mijë euro. A hynë në këtë projekt edhe shtimi i kapaciteteve të laboratorit, që qytetarët të marrin shërbime në orar më të gjatë, jo vetëm deri në ora 13:00, ose edhe brenda orarit kur i sëmuri shkon në kontroll? Çështja është se, kur po jep mjeku për analiza, i kërkohet me bërë termin për nesër. Lë të hiqet kjo çështja e terminëve, se po mall treshen qytetarët.

**z. Bahri Selimi:** Të shëndetësia janë 35 mijë euro të ndara, për furnizime me pajisje laboratorike, për me gjerë shpjegime është drejtori i DSHMS. IK ka me pasur grantin shëndetësia për vitin 2026, ka me pasur projekte për mirëmbajtje, investime. KBAK nuk do të thotë që nuk ndryshon deri me 30 shtator. Janë krejt 150 mijë euro nga granti, ndërkaq për orarin, nuk jam kompetent me dhënë sqarime. Ndryshimi është bërë Ardita të QMF, ishte shqetësim me vend, se disa QMF janë funksionale. Ne pas 15 majit 2025, e kemi pranuar qarkoren e parë buxhetore, lartësinë e buxhetit për të gjitha organizatat buxhetore e cakton MF., e cila fillimisht e ofron një dokument strategjik KAB në nivel qendror, aty i parashihet projektet buxhetore të komunave. Në vazhdim drejtori e përmendi në total grantin e përgjithshëm për komuna, kur është rritur granti për komuna, komunës tonë i janë shtuar nja 500 mijë euro. Në vitin 2026, kemi me i pasur 557 mijë euro me tepër. Kur të shpërndahet buxheti nëpër kategori ekonomike, kjo rritje nuk na mjafton, për shkak të rritjes së shpenzimeve tjera që na kanë ndodhur. Për dallim nga vitet tjera, vetëm pagat në vitin 2026, kanë me qenë për 1 milion e 170 mijë euro me tepër. Për me i mbuluar pagat, i kemi zvogëluar IK për 640 mijë euro dhe 45 mijë euro MSH. Kemi rënie të IK, kemi mjetet nga bartjen, dhe nuk e dimë sesa kemi me pasur bartje në vitin vijues. IK kanë rënie në vitin 2026, për shkak të buxhetit të pamjaftueshëm. Sektorët që u përmenden, bujqësia, sektori ekonomik janë me prioritet, bujqësia nuk shquhet për IK, diku 50-75 mijë euro i kemi pasur vit për vit, vitin vijues kemi me i pasur 50 mijë, kryesisht për ndërtimin e ndonjë kanali të ujitjes etj., për subvencione kanë qenë të miratuara 120 mijë euro, njëjtë është edhe në vitin tjetër, dhe vazhdimisht ka me pasur ngritje të donatorëve sikurse që ka pasur deri tani, që 4 vitet e fundit ka pasur shumëfishim të buxhetit të ndarë për subvencione. Të zhvillimi ekonomik, 75 mijë euro janë për projekte kapitale, e jo siç u tha 25 mijë euro, subvencione janë 50 mijë euro. Rënia e IK me së paku e ka prekur sektorin e zhvillimit ekonomik dhe atë të bujqësisë. Rënie të IK ka të urbanizmi, shërbimet publike dhe në arsim për 250 mijë euro, ndërkaq ngritje kanë shërbimet sociale dhe kultura, rina dhe sporti.

**z. Agim Mani:** Ato që i potencova, u bazova në dokument, ku thashë se i keni dhënë vet prioritet bujqësisë, ndërkaq nuk keni paraparë në bazë të këtyre prioriteteve investime kapitale në sektorin e bujqësisë. Unë nuk i përmenda subvencionet, se ato janë çështje tjetër. Çka si ekzekutiv mendoni me zhvilluar bujqësinë që e keni futur në listën e top prioriteteve dhe keni ndarë 50 mijë euro, apo për zhvillimin e turizmit, që i ndani vetëm 25 mijë euro dhe atë që i shfrytëzoni në zhvillimin e kioskave?

**z. Bahri Selimi:** Të zhvillimi i turizmit, total buxhetin e ka 170 mijë euro, përfshirë me paga e krejt shpenzimet tjera, 75 mijë euro janë për projekte kapitale, e jo 25 mijë, mos është ndonjë gabim.

**z. Agim Mani:** Shumën 25 mijë euro i keni ndarë për kioska të sheshi.

**z. Bahri Selimi:** Shuma 25 mijë euro janë vetëm për atë projekt.

**z. Agim Mani:** Për projekte zhvillimore, 50 mijë euro: ndërtimi i kioskave 25 mijë euro. Qytetarët presin me së shumti që t'iu kthehet TP në investime kapitale. Ky është keq menaxhim i politikave të juaja lokale, për atë ka ra numri i popullsisë. Qytetarët nga komuna jonë po

shkojnë me jetuar në Ferizaj, për atë ka ra buxheti i komunës. Nëse vazhdohet me rënie të numrit të popullsisë, IK nuk ka me pasur në Kaçanik.

**z. Bahri Selimi:** Është viti i parë që kanë ra IK, se që 4 vite ka pasur ngritje, por për me i mbuluar ngritjen e pagave, është dashur me u zvogëluar kategoria ekonomike e IK, mirë që po ngritën pagat, por në këtë rast nuk e kemi mbulesën e mjaftueshme. Unë e potencova se buxheti është me i madh për 577 mijë euro apo 5%, ndërsa në start ne i kemi i llogaritur se pagat dhe mëditjet na dalin diku 1 milion e 200 mijë euro me të mëdha, kështu është dashur me i zvogëluar IK, pasi tani ministria nuk i mbulon dhe komunat duhet zvogëlojnë IK dhe MSH.

**Kryesuesi i Kuvendit:** IK kanë rënë, për shkak të rritjes së koeficientit të pagave, që duhet me i mbuluar. Shpërngulja e popullatës. Deri tani ka pasur ngritje të IK. E kemi diskutuar edhe me herët për shpërngulje të banorëve, një arsye është mungesa e PZHK apo zvarritja e PZHK, ndikon në marrje të lejeve ndërtimore dhe zhvillimin e komunës. Për këto kushdo që është fajtor, ka me paguar faturën.

**Nënkryetari i Komunës-Sabedin Vishi:** Po përgjigjem në disa pyetje që kanë shqetësime anëtarët e KK. E thatë se është duke u zhvilluar një politikë regresive e vazhdueshme. Unë nuk e di a është regresive apo progresive, nëse për një mandat në sektorin e bujqësisë janë paraparë 300 mijë euro për 4 vite, mendoj se është progresive. Për IK që u tha se ka zvogëlim të tyre, duhet me i ditur arsyet pse ka zvogëlim të IK, e potencoj edhe drejtori edhe kryesuesi, për mbulimin e ngritjeve të shpenzimeve të pagave nga 1 janari nga 55 euro dhe nga 1 korriku për ngritjen e gjashtëmujorin e dytë, ku e ka paraparë drejtori se është një shumë për një vit 1 milion e 177 mijë euro, pasi nuk mbulohen nga niveli i ministrisë që i ka ngritur pagat, ato mjete mbesin barrë e komunës, kështu që ne nga 5 kategori buxhetore, është dashur me i hequr të kategoria që prek me së shumti interesin e qytetarëve-kategoria e IK. Të zhvillimi ekonomik, të sektori i sportit, në qoftë se i marrim të dhënat, brenda vitit 2022, subvencionet në DKRS kanë qenë 70 mijë euro, sivjet 110 mijë euro, nuk e di a është progres apo regres? Po ashtu kemi subvencionuar të turizmi të bizneset, që vazhdimisht kemi pasur ngritje të subvencioneve në zhvillim ekonomik, në raport me buxhetin që e kemi. A janë të arsyeshme kërkesat e juaja, normal se janë të arsyeshme, por me buxhetin që e kemi, është e pamundur të realizohen të gjitha kërkesat. KBAK është një dokument orientues dhe nëse deri me miratimin e buxhetit, ka ndonjë kërkesë me të arsyeshme, mund të ndryshohet, por dine se duhet me hequr një projekt dhe me shtuar projektin me më prioritet. Për atë janë dëgjimet publike për me i shikuar se cilat projekte janë me më prioritetet. U tha se po zhvendosën qytetarët e komunës në vende tjera, në mungesë të PZHK. Ju e dini se në vazhdimësi është ngritur çështja e PZHK nga Ardita dhe të tjerët, dhe ju e dini se në vazhdimësi kemi adresuar emaile, nuk na kanë kthyer përgjigje që PZHK me i zhvilluar procedurat e debatit publik me qytetarë dhe procedurat e miratimit. A e merr dritën e gjelbër apo jo, varet prej ministrisë dhe prej qytetarëve të komunës. Nëse është gabim PZHK që e kemi dërguar në ministri, lë të na kthejnë me gabime, dhe e përmirësojmë aty ku nuk është në rregull. Me kemi shikuar me ligj që për disa parcela, me bërë ndërtim të lartë, që është shqetësim i jonë dhe i juaji për mos me u zhvendosur popullata në komunën e Ferizaj. Është shumë e dhimbshme që banorë të Kaçanikut që jetojnë në perëndim, me blerë banesë në Ferizaj e jo në Kaçanik. Kjo po bëhet në mungesë të PZHK, që është si pasojë e mos kthimit të përgjigjes nga ministria kompetente, ndërkaq e dimë se kush është fajtor për këtë punë. Ne e kemi hartuar PZHK, e kemi diskutuar shpesh këtë temë, por ende nuk kemi marrë ndonjë përgjigje.

**znj. Ernesta Krasniqi:** E kam një pyetje për kategorinë e arsimit, duke ditur se e kam pasur kërkesë të vazhdueshme për rritjen e numrit të bursistëve dhe vlerën e bursës. A e keni paraparë me bërë këtë rritje, apo prapë nuk është marrë parasysh kërkesa jonë?

**Nënkryetari i Komunës:** Shuma e subvencioneve në arsim është e njëjtë me përjashtim të një shume që e potencoj edhe drejtori. Shuma e bursave për vitin vijues është e njëjtë, mendohet të shtohet nga të HVK, varësisht prej buxhetit të paraparë, se po jemi në vazhdimësi të hendikepuar për shkak të kontratës kolektive, e cila ka qenë barrë e rëndë, kur e dimë se projektet që kanë qenë të parapara për sivjet, është dashur me i hequr pa fajin e arsimtarëve, për shkak të mbulimit të shpenzimeve të kontratës kolektive. Për ato që kemi marrëveshje, duhet me i paguar, për ato që nuk kemi, janë në gjykatë të apelit, në momentin që na vijnë vendimet e gjykatave, nuk na pyesin fare, na i marrin mjetet. Kështu që është dashur me bërë kalkulime, gjithmonë duke i pa edhe kërkesat tjera të arsimit, për arsye se mundet me ndodhur që me rritë shumën, por nuk mundesh me realizuar, ne duhet me shqyrtuar prapë mundësinë qoftë për arsim, studentë, biznese etj.

**znj. Ardita Rrahmani:** Po e marrë fjalën, nuk e pata ndërmend me diskutua, po ndërlidhem me fjalën e nënkryetarit, ku theksoj se ne i japim prioritet projekteve, pastaj i bëjmë edhe ndryshimet në buxhet. Kjo është shumë e mirë, por edhe ne jemi pjesë e këtij qyteti, ku edhe kërkesat të cilat vijnë nga ne, duhet ju me iu dhënë prioritet. Po flas në emër të LDK se kemi paraqitur kërkesa, i kemi kontribuar buxhetit, edhe në buxhetet e viteve tjera madje, por nuk janë marrë me prioritet qoftë të paktën një kërkesë. E kuptoj se është vit zgjedhor, ju i keni dhënë prioritetet e juaja në vija të trasha, por edhe ne jetojmë në Kaçanik, dhe me të njëjtit qytetarë që bashkëvepronë ju, bashkëveprojmë edhe ne.

**z. Naim Beça:** E kam një pyetje, të DKRS, janë ndarë diku 150 mijë euro, kurse, në pikën 1. Është rregullimi i varrezave të dëshmorëve dhe veteranëve të luftës së UÇK. A mundeni me na sqaruar çka ka me u ndërtua aty? Në vitet tjera nuk ka qenë kjo, se vetëm për mirëmbajtje - rregullimin e varrezave, është një shumë bukur e madhe. A ka ndonjë plan se çka ka me u ndërtua aty, qysh shkojnë këto para të ndara? E dyta: Kërkoj sqarim për projektin, Ndërtimi dhe rregullimi i terreneve sportive, ku janë të ndara diku 100 mijë euro.

**Nënkryetari i Komunës:** Janë ndarë 150 mijë euro për rregullimin e varrezave të dëshmorëve dhe veteranëve të luftës së UÇK. Ju e dini se është investuar të varrezat e dëshmorëve, tani ka mbetur pjesa të shkallët, e i hequr shkallët që janë me gurë, me vendosur shkallë tjera, se ato kërcasin. Ky është ndoshta një ndër projektet me të mira që bëhet në nivel të Kosovës. Edhe ju duhet me përkrahur atë projekt, ku janë themelet e lirisë. Të terrenet sportive, janë ndarë 100 mijë euro, me mundësi bashkëfinancimi të ndonjë OJQ me rritë shumën. Të kërkesa e Arditës, ka kërkesa të juaja që i kemi realizuar, por ka edhe që nuk i kemi realizuar.

**z. Agim Mani:** Po duhet me marrë fjalën pas fjalimit të nënkryetarit, i cili po shtirët si viktimë, mirëpo mbrojtja me e mirë është sulmi. Në këtë rast, po e sulmon qeverinë, sidomos të faqja 6 që e keni thënë: “Nga niveli qendror deri me tani është bërë mjaft në thithje të investimeve, mirëpo sidomos në vitin e fundit mungon qasja e duhur nga niveli qendror”. Unë mendoj se kjo është e kundërta, deri me tani nuk është arritur, por kohën e fundit është arritur mjaftë. Ju e dini që me buxhetin e miratuar të qeverisë së Kosovës, komuna e Kaçanikut ka përfituar mbi 13 milion euro. Projekti i cili ka filluar këtë vit, në Kaçanik, është mbi 2 milion, dhe projektet tjera që do të fillojnë, asnjëherë Kaçaniku nuk ka pasur një buxhet të ndarë nga qeveria. Ju si ekzekutiv e keni humbur shansin me të mirë që keni pasur për, Projektin për përballim të qëndrueshëm dhe social. Ju është dashur me siguruar parcelën, ndërkaq mjetet kanë qenë të ndara prej qeverisë. Komunitat të cilat e kanë zgjedhur këtë problem, i kanë filluar punimet, kështu që, nuk bënë me u ankuar në qeveri, por në vetën e juaj, se kjo është humbje që ia keni bërë komunës së Kaçanikut.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Sa i përket këtyre çështjeve që u përmendën, po diskutoj edhe unë pak. Ne jemi që 5 vite nën qeverisjen aktuale, na është premtuar edhe me herët projekti i shkollës në Doganaj, që është në gjendje të keqe, por nuk është realizuar. Unë nuk kam përgjigje, nëse

keni ju, është mirë me na treguar. Ky projekt është përsëri në projeksion, i jam falënderues që e kanë parapa, ndërkaq a e realizojnë, nuk e di. Çdo projekt që vjen në Kaçanik, është i mirëseardhur, këtë e kam përmendur edhe në fushatë elektorale, kushdo që ka mundësi me bërë diçka për Kaçanik, është mirë. Në aspektin politik, si kundërshtarë politik për mua jeni të njëjtë, si LVV si LDK, por nuk mundemi me thënë që Lufti Zharku nuk ka sjellë projekte në Kaçanik. Për qeverinë e LVV lutemi që këtë mendësi që kanë nisur, të vazhdojnë, çdoherë kam me i përkrahur kudo që investojnë, se nesër nuk do të jemi në politikë as unë as ju, por të paktën kemi me dalë para qytetarëve me iu thënë se kaq kemi pasur mundësi me bërë për Kaçanikun. Me herët mundësitë kanë ekzistuar, shpresoj të kenë seriozisht tani.

**Nënkryetari i Komunës:** Unë e përmenda realitetin që ekziston, ndërkaq i duartrokas çdo projekti që vjen nga niveli qendror për komunën tonë, se janë investime për qytetarët tonë, për të mirën tonë. Ato 13 milion euro që u përmendën, është mirë me i deshifruar se ku kanë shkuar? Rruga Kaçanik -Kërbliç ka qenë marrëveshje e ministrisë me komunën e Vitisë, tanë vetëm është vazhduar.

**z. Bashkim Luma:** Edhe projektin e Palestrës sportive e keni harruar, e cila ka filluar në vitin 2024, ndërkaq ka përfunduar në kohën e qeverisë Kurti.

**z. Naim Beça:** Të projekti, vendosja e paneleve diellore në shkolla, çfarë panele kanë me u vendosur, se ka shumë lloje të paneleve. Nëse vendosën vetëm për diell, ata ndoshta nuk janë funksionale. Të çfarë cilësisë kanë me u vendosur, me na sqaruar me tepër, se nëse nuk janë funksional, 50 mijë euro janë shumë veç me shpenzuar mjete për digjitalizim të shkollave. Nëse sivjet kushtojnë 50 mijë euro, vitin tjetër kanë me kushtuar edhe 10 mijë euro, se e kemi ne një përvojë kështu sikurse të kompjuterët që vitin tjetër nuk kanë funksionuar.

**Nënkryetari i Komunës:** Të digjitalizimi i shkollave, të shkolla "Emin Duraku" janë ndarë 50 mijë euro, po ju duket shumë e madhe, nuk është shuma e madhe, se me tabela digjitale, shumësata më nuk përdoren. Në Shkollën e gjimnazit janë tre tabela digjitale, ku janë shumë të kënaqur stafi dhe nxënësi, se po ecin me kohën me përparimin e teknologjisë. Të panelet diellore, kemi pasur të SHMP donacione nga KFOR italian, janë panelet diellore edhe çerdhja e fëmijëve, ne i kemi ndarë do shuma, ndërkaq për llojin, nuk jam profesionist me i ditur, bëhet projekti me paramana dhe para llogari e shikojnë profesionistët, nëse ka nevojë për mjete, shtohen nga të HVK, nëse mbesin shkojnë në ndonjë projekt tjetër.

**z. Rrustem Zenuni:** Gjatë zhvillimit të debatit, po lindin tema me u kyçur. Ne duhet me kuptuar sistemin që jemi dhe që organizohemi. Në Kosovë organizimi i komunave bëhet nga niveli lokal, janë deleguar kompetencat komunave që me vendosur se nga me u zhvilluar me IK. Ne kemi bërë shumë punë, niveli qendror nuk na kanë mbështetur, i kanë arsyet e veta, në të kaluarën u investuar shumë këtu. Ne në vitin e kaluar kemi pasur shumë projekte që i kemi dërguar në ministrinë e infrastrukturës. Është mirë me na pyetur neve, se çka keni nevojë ju si komunë, apo ata me na imponuar nevojat? Komuniteti ynë nga vijë unë, e kemi pasur në plan, ndërtimin e një terreni sportiv, të xhamia. Ne e kemi dërguar projektin në qeveri me na mbështetur, nuk kemi marrë përgjigje, na kanë injoruar. Është dërguar projekti i rrugës: "Hamëz Jashari", është injoruar, dhe projekte të shkollave, është bërë bajat kjo punë që 5 vite. Kryesues, është mirë me qenë ne me real, mos me bërë propagandë këtu. Unë nuk dua me i pa kolegët tonë, mos me ngritur dorën, me qenë kundër investimeve në komunën tonë. Ne kemi shumë probleme që nuk janë zgjedhur, ndërkaq mirë që ka ardhur projekti i rrugës: Kaçanik-Kërbliç, se dikush e shfrytëzon atë rrugë. Unë nuk e shoh se janë bërë keq planifikime të IK as të ne as në Stagovë, as në vende tjera, krejt mbështetja jonë është për plan për kornizë, ka qenë me i zgjidhur probleme dhe me ato kapacitete që ka, i ka zgjidhur në masë të madhe, e jo me na treguar neve për projektin për banim social të përbalueshëm. Ne kemi problem rrugët për të stanet. Në plan të ekzekutivit të komunës, është thënë me i zgjidhur problemet që ka komuna dhe me ato kapacitete që i ka pasur, i ka zgjidhur.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Nuk po mundemi pa e marrë fjalën, kur kolegu thotë se e kemi zgjidhur çështjen e banimit social. Banimi social ka kohë që ka filluar punimet në vitin 2017, ende janë duke zgatur procedurat, janë duke kaluar disa zgjedhje me banimin social. Nuk ka qenë vetëm çështja e banimit social, ka qenë edhe banimi i përballueshëm. A po mendoni se nuk ka nevojë komuna jonë për banim të përballueshëm, ka shumë qifte të reja që kanë nevojë për banim të përballueshëm. Është mjerim, ti e zgjidhë problemin e banimit, dikush nuk mundet me zgjidhur. Ti je duke bërë projekte në bazë të interesave tuaja personale, realisht është mjerim kur thoni se, e kemi zgjidhur problemin për banim social. Nuk keni zgjidhur asgjë, nuk mundeni me i thënë kryesuesit me ma ndërprerë fjalën mua, se i dëgjova me drejtor, nënkryetar, tani kur të dua e ndërpresë fjalën.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ju lutem, pa ofendime.

**z. Selajdin Troni:** Ne po flasim këtu me shumë duke e mbrojtur njëri tjetrin. Qysh mundeni me fol me mbrojtur qeverinë për një rrugë që e keni bërë, që është shumë e mirë, e nuk e keni ngritur zërin për shkollën në Doganaj, e cila është në gjendje të mjerueshme, e keni pasur edhe deputetin, zëvendësministrin, ndërkaq e keni bllokuar PZHK, ju e keni bllokuar. Pastaj, çështja e parkingjeve nëntokësore, brenda ditës i kemi pasur 2 vendime, njëra me vazhduar punimet, tjetra me i ndalur punimet. Shkolla në Doganaj, nxënësit mësojnë në atë shkollë ku ka insekte, ndërkaq na tregoni cila është me e rëndësishme, a shkolla në Doganaj, apo rruga e cila nuk mendoj se është me e rëndësishme sesa shkolla? Pas 5 vjetëve thoni se nuk keni bërë projekte. Projektet janë të gatshme, por nuk doni me fol për qeverinë, se ju dimë e ju njohim. Ne po flasim për këtë buxhet që e kemi, që po mundohem me iu shërbyer interesave të qytetarëve.

**znj. Ardita Rrahmani:** Kemi dalë komplet prej rendit të ditës, këtë e kemi fal kolegëve të mijë, Rustemit dhe Selajdit. Pavarësisht se jemi jashtë rendit të ditës, jemi duke folur për buxhetin e komunës që iu takon të gjithë qytetarëve. Pajtohem Selajdin për çështjen e dezinfektimit të shkollës në Doganaj, është njëra prej kërkesave të mia të para, drejtori i shëndetësisë është këtu, dhe përgjigjen që e kam marrë, kemi me pa. Që 4 vjet duke pa, e mos vepruar. Jemi të vetëdijshme për gjarpërinjtë jo vetëm në Kaçanik, por në krejt territorin e Republikës së Kosovës. Çka është marrë në këtë drejtim, përpos do serumave në ambulantë, duhet me i ndalë mos me na kafshuar, se kur të ndodhë, e dimë ku shkojmë. Për mua të gjithë jeni njëjtë, ne jemi duke folur shumë, por kur të vjen puna, nuk veprojmë. Nuk po e amnistoj asnjërin nga ju, por gjeni zgjidhjen. Kur po i konvenon pushtetit lokal, po i hapni krahët po thoni kemi punuar në objekte shkollore, ndërkaq kur nuk po i konvenon, thuhet qeveria i ka fajet. Kjo është dyanshme. Ne nuk jemi duke folur për nivelin qendror, se e dimë sa ka investuar.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Si përmbledhje e krejt kësaj, ne këtu jemi të subjekteve të ndryshme, ndërkaq një qëllim na bashkon, por rruga me arritur atë qëllim është e ndryshme, ju keni rrugë tjetër, ne rrugë tjetër. Unë mendoj se rruga ime me arritur atë qëllim, është me e mirë, ndërkaq ju thoni se rruga me arritur atë qëllim është e imja. Në fund është dikush krejt tjetër që vlerëson se cila rrugë është me e mirë. Mos të bastardojmë debatin, se është dikush që i zgjedhë ato rrugë, për ata që kanë punuar, kanë me u shpërblyer. Kështu që t'i japim mundësitë tona dhe qëllimet tona të mira dhe të sakta, me mirëkuptuar njëri tjetrin.

**z. Selajdin Troni:** Nuk është hera e parë që Ardita thotë se jeni një brumë, kjo është përdorur që 4 vjet. Nuk e di se në çfarë konteksti e thotë. Unë nuk jam provincial, ashtu qysh e dua vendin tim Kovaçecin, ashtu i dua vendet tjera. Unë po shoh fusha që po rregullohen, po shoh parqe, sheshe të cilat janë bërë me buxhetin e komunës e që po i shfrytëzojnë fëmijët tanë, ju ndoshta nuk jeni duke i pa. Po i shohim rrugët e mira, trotuaret, gabime normal se ka. Unë thashë nuk jam provincial, po me vjen mirë që po ndërtohet edhe rruga për Kashan, se të gjithë e shfrytëzojmë. Kisha kërkuar nga Ardita këtë çështje një brumë, në çfarë kuptimi është duke e thënë, se kjo shprehje është njëfarë ofendimi.

**znj. Ardita Rrahmani:** Me gjithë respektin Selajdin, për mua jeni krejt një brumë, por me atë brumë unë bisedoj çdo ditë, bisedoj me juve, me Agimin, Kadrijen. Politikat të dy grupet që po ju drejtohem, i keni të njëjta, pajtohem me kryesuesin, rrugën e keni të ndryshme. Tjetra, projektet që i përmende se jemi duke i parë, rrugët, parkun që jeni duke e parë ju, edhe unë po e shoh, parku që 10 vjet, tre herë është duke u ndërtua. Kush është duke e ndërtua, me tregoni çfarë vlerë ka ai investim i parkut?

**z. Naim Beça:** Po ia përmendi emrin Selajdinit: Kush të ka thënë që nuk ka pasur angazhim për çështjen e shkollës? Angazhim kam pasur personalisht, kryetari nuk është këtu, dhe jemi takuar me ministrin shumë ne nga të LVV, i kemi qitur çështjet në tavolinë se çka ka komuna, çka ka ministria. Ministria ka qenë e gatshme për ndërtimin e shkollës tonë. Shkolla fillore në Kaçanik u ndërtua në vitin 1959. Qeveria nga LVV është që 4 vite në pushtet, ndërkaq për 25 vjet pas çlirimit, nuk mundeni me ia lënë fajin asnjëherë. Ju tani për IK mundeni me akuzuar kënd të doni, por jo këtë qeveri. Kaçaniku ka qenë qytezë para lufte, Vitia nuk ka qenë qysh është, po ku kanë mbërri tani, nuk ka qenë Albin Kurti, po ku ka mbërri Vitia, Lipjani, Fushë Kosova dhe do komuna tjera.

**znj. Ardita Rrahmani:** LDK ka udhëhequr në këto komuna.

**z. Naim Beça:** Ku është Malisheva sot, ku është Kaçaniku, ne nuk mundemi me mallkuar vetëm një parti. Për çështjen e brumit, LVV e ka brumin e vet, e ka dinjitetin, PDK gjithashtu, ne jemi një komb, që po na shihni ju si një brumë.

**znj. Ardita Rrahmani:** Unë ju shoh ashtu.

**z. Naim Beça:** Nuk e di në çfarë kuptimi po e thoni çështjen e brumit, unë e marrë si ofendim, unë nuk e di çfarë brumi keni ju. Ne nuk kemi bërë koalicion me Lista serbe. Ne jemi një komb, të mirë apo të keq, edhe ti je aty.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Përfundoj çështja e këtij debati, për shkak se zgjati shumë dhe janë përsëritur çështjet nga 3-4 herë. Naim, të falënderoj që ke qenë aktiv në kërkesat, po të falënderoj personalisht nëse ke dhënë kontribut edhe për çështjen e shkollës në Doganaj, juve dhe secilin që ka dhënë kontribut, por para se gjithash, kisha kërkuar prej jush që me kërkuar llogari prej ministres, dhe keni pasur të drejtë me i thënë, se çka ke bërë deri sot, se neve po na akuzojnë dhe ju kemi akuzuar realisht. Projekti i ministrisë është nga viti 2020 i stagnuar për 5 vjet. Për atë që keni dhënë kontribut dhe të tjerët që projekti me ecur përpara dhe po me duket se ka ecur përpara. Ju falënderoj personalisht, është dashur edhe llogari me kërkuar për këto 5 vjet, pse ka stagnuar, a për inate politike apo diç tjetër. Nuk bënë, se me shumë është e fëmijëve dhe ata fëmijë, pa fajin e tyre, janë të krejt partive politike. E kam një kërkesë për projektin e trotuarit të rrugës “Ahmet Kaçiku” e kam përmendur edhe në KPF se nuk është në draftin kornizë, projekti i cili është hartuar nga qytetarët dhe bizneset aty, është në realizim e sipër, ka ngelur edhe një pjesë, e cila propozoj të hynë në buxhet në vitin 2026. Jam i vetëdijshëm për koston, dhe mundësitë buxhetore, të ekzistoj si kod buxhetor, rruga është shumë e frekuentuar, përshkohet nga jo vetëm nga qytetarët e Kaçanikut, por nga qytetarët e gjithë Kosovës, e përshkon një komunitet që janë taksapaguesit me të mëdhenjtë se ka shumë biznese aty, propozoj të hynë në KBAK 2026-2028. Diskutime të tjera nuk ka, e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me 18 votë Për, Kundër votë 7- LVV, Abstenim nuk ka. Prezentë 25. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për Aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore e Komunës (KABK) së Kaçanikut 2026-2028/ Lënda: 01Nr. 400/01-13692/25.**

3. Propozim Rregullore për transportin rrugor në territorin e komunës së Kaçanikut;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Materialin e keni marrë, drejtori është këtu, nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Si rregullore është shumë e mirë, shpresoj se do të zbatohet duke iu përmbajtur rregullave të caktuara. Pyetje për drejtorin: Kur nxënësit po janë në pushim, linjat si Gllloboqicë, Stagovë, nuk po i mbajnë linjat si në oraret e caktuara kur ka nxënës. A jeni në dijeni për këtë dhe a figuron në rregullore që linjat e rregullta mos me funksionuar sipas orarit të rregull, në kohën kur nuk ka nxënës?

**z. Agim Mani:** E diskutuam edhe në KPF, çështjen e një orari të udhëtimeve Kaçanik-Ferizaj, drejtori tha se, nuk është në kompetenca lokale që në ora 23:30 me pasur linjën për udhëtim, për punëtorët që punojnë deri në atë kohë.

**z. Ramadush Osmani:** DSHPE ka rregullore aktive nga viti 2014, ne funksionojmë me atë rregullore, por gjatë rrugës, është pa e arsyeshme, për shkak të ndryshimit të ligjit për transport rrugor, dhe për shkak të praktikave të komunës tonë, për shkak se ndryshimet kanë tejkaluar ndryshimet e lejuara, për plotësim ndryshim të rregullores, kemi kaluar me rregullore të re. Kryesisht janë bërë ndërhyrje në pjesën e licencave-kushteve për me u pajisur me licenca për operatorët që operojnë. Kështu që edhe përmes debatit publik që janë mbajtur me grupet e interesit-operatorët, janë ndarë të kënaqur me mënyrën e licencimit për të ardhmen. I kemi licencuar deri me tani në çdo vit, ndërkaq tani licencohen për 5 vite dhe rendi i udhëtime për tre vite, siç vepron edhe në ministri në këtë formë. Ka edhe ndryshime tjera, se tani është futur edhe sistemi merimangë, rregullimin e operatorëve që donë me funksionuar me shërbimin merimangë dhe kushtet e licencimit të tyre. Të pyetja e Kadrije, po është e vërtetë, gjatë kohës kur nuk ka nxënës, e lënë mundësinë operatorët privat me miratim të drejtorisë dhe me vërejte, që gjatë kohës kur nuk ka nxënës, kanë mundësi me i reduktuar linjat, sepse ndërhyjnë në koston operative të operatorit, mirëpo me një kërkesë në drejtori dhe me miratimin paraparak, ose gjatë miratimit të rredevave të udhëtimeve, me caktuar në fund me vërejtje.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, e shtoj në votim për aprovim këtë rregullore dhe e njëjta u aprovua me njëzëri. Prezentë 22. Kur u votua kjo pikë nuk ishin në sallë: Raif Kasa, Kadri Krivenjeva, Bashkim Krasniqi, Naim Beça. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për Aprovimin e Rregullores Nr. 03/2025 - Për Transport rrugor në territorin e komunës së Kaçanikut /Lënda: 01Nr. 07-104/02-13626/25.**

4. Propozim Rregullore për transparencë e komunës së Kaçanikut;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Lidhur me këtë pikë e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Prezentë 22. Nuk janë : Raif Kasa, Kadri Krivenjeva, Bashkim Krasniqi, Naim Beça. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës,

#### APROVOJ

**Rregullore Nr. 04/2025 -për transparencë e komunës së Kaçanikut/ Lënda: 01Nr. 104/02-13630/25.**

5. Plani i veprimit për transparencë e komunës së Kaçanikut;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Krahas rregullores, është hartuar edhe plani i veprimit për transparencë. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Nuk janë në sallë: Raif Kasa, Kadri Krivenjeva, Bashkim Krasniqi, Naim Beça. Prezentë 22. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

## VENDIM

**Për Aprovimin e Planit të veprimit për transparencë e komunës së Kaçanikut/Lënda: 01Nr. 104/02-13626/25.**

6. Propozim Vendimi për rialokimin e mjeteve buxhetore sipas buxhetit të vitit 2025;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Fillimisht drejtori kërkoj me dhënë një sqarim, pastaj e hapim diskutimin:

**z. Bahri Selimi:** Shuma 45 mijë euro e kemi marrë pasi rruga: Runjevë-Stagovë-Kaçanik i Vjetër, është planifikuar vitin e kaluar me u kryer, mirëpo për shkak të ankesave të operatorit ekonomik, nuk ka arritur me u lidhur kontrata në vitin e kaluar. Ju e dini që me ligjin e financave publike, mbarojnë ndarjet buxhetore me 31 dhjetor, ato që kanë qenë të planifikuara bien poshtë, fillon viti i ri fiskal. Në vitin 2025, kemi pasur mungesë të mjeteve, për shkak që OSHP ka marrë vendim që kjo kontratë me iu dhënë një operatori ekonomik i cili i ka plotësuar kushtet, por jo me herët, vendimi është marrë me 27 shkurt, e jo para vitit të ri. Kontrata është lidhur me 13 mars, në vlerë 221 mijë, 127 euro dhe mungojnë mjetet për shkak se ndarjet buxhetore të vitit të kaluar bien poshtë, se atëherë kemi llogaritur se kanë me përfunduar, nuk kemi parapa mjete për këtë projekt. Sivjet jemi duke u munduar me i siguruar mjetet, meqë është lidhur kontrata, përmes këtij vendimi të plotësohet obligimi i kontratës me kryer atë projekt të rëndësishëm, i cili disa vite me radhë ka dështuar.

**Kryesuesi i Kuvendit:** E hapi diskutimin:

**z. Agim Mani:** Kur është miratuar buxheti i vitit 2025, janë mbajtur edhe dëgjime publike, në bazë të tyre dhe prioriteteve të caktuara, është ndarë një shumë e mjeteve 50 mijë euro për rehabilitimin e rrugës Stagovë. Kur qytetarët e f. Stagovë e presin rehabilitimin e rrugës e cila është në gjendje të mjerueshme, ju e stoponi këtë projekt dhe nuk e realizoni. Për kundër asaj që nuk po e realizoni këtë projekt shumë të rëndësishëm, ju po bëni shkelje tjetër, ku rialokimin e këtyre mjeteve i orientoni në një projekt që është në realizim e sipër. Ju e dini që procedurat e prokurimit, fillimisht para se me u kryer procedurat, bëhet zotimi i mjeteve. Nëse nuk janë mjetet e zotuar, nuk lejohet me shkuar tutje procedura. Ju i keni zhvilluar të gjitha procedurat e prokurimit, ndërkaq e keni filluar me shtruar rrugën pa i pasur mjetet.

**z. Bahri Selimi:** Mjetet i kemi të zotuar në vitin e kaluar.

**z. Agim Mani:** Mirëpo, është me rëndësi me filluar puna, për ato mjete sa i keni dhe mos me lënë anash projektin. Ky projekt që ju keni filluar, lë të vazhdoj aq sa ka mjete, se janë fazat, faza I dhe faza II, por kjo është bërë me qëllim politik, me i marrë mjetet dhe me shtruar rrugën në fushatë zgjedhore. Kjo është një e padrejtë që ua bëni qytetarëve të Stagovës.

**z. Bahri Selimi:** Mjetet kanë qenë të zotuar në vitin e kaluar, mirëpo OSHP është dashur para fillimit të vitit 2025, me marrë vendim, se janë afatet ligjore për me marrë vendime, e jo me marrë vendim me 27 shkurt, kur kemi filluar me ekzekutim të buxhetit 2025. Ne duhet me bërë zgjidhje, meqë projekti është i rëndësishëm, ne duhet me siguruar mjete, kemi adresuar propozim vendimin në KK që përmes juve me vendosur. Nëse ju nuk na ndihmoni, nuk kryhet, përsëri dështon, por ne e kemi sjellë për rialokim të mjeteve që është e paraparë me ligj. Pasi të rialokohen mjetet, bëhet zotimi. E di se është bërë me vonesë, por OSHP na ka sjellë në këtë gjendje ku jemi, se me vend e keni se mjetet duhet të zotohen paraprakisht.

**z. Agim Mani:** Drejtor ju e dini që sivjet janë bartur mbi 1 milion euro nga të HVK të cilat nuk janë realizuar në vitin e kaluar. Pse nuk i keni marrë mjetet nga këto, që mos me i prekur projektet tjera? Mbi 1 milion euro janë bartur, ndërkaq nuk keni qenë në gjendje me ndarë një kosto nga këto mjete, të cilat janë bartur para 2 muajve, pasi ka marrë vendim OSHP. Shumën

prej 261 mijë euro keni pasur mundësi me proceduar dhe me kryer projektin pa i prekur projektet të cilat janë miratuar me buxhet.

**z. Bahri Selimi:** Pjesë e bartjes së mjeteve, është edhe ky projekt, por nuk ka mjaftuar krejt shuma me u bartur, edhe pse bartja teknikisht ende nuk ka kaluar nga ministria, edhe kur barten, nuk mjafton kjo shuma 45 mijë euro. Është shuma 1 milion e 38 mijë me u bartur, nuk janë bartur krejt në IK, ato që janë bartur, shumë projekte na i ka copëtuar- prishur, kontrata kolektive e arsimit. Kemi proceduar mjete për plotësim të saj, që me i pas pasur edhe 1 milion euro, nuk kishin mjaftuar.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, këtë pikë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me 18 votë për, Kundër ishin 7 anëtarë nga LVV, Abstenim nuk ka. Prezentë 24. Në sallë nuk janë: Raif Kasa, Betim Shala. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

### VENDIM

**Për rialokimin e mjeteve buxhetore sipas buxhetit të vitit 2025/Lënda: 01Nr. 13773/25.**

**Kryesuesi i Kuvendit:** Kalojmë në pikën 7. Nga pika 7-14 kemi të bëjmë me raporte të drejtorisë për realizim të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

**z. Rustem Zenuni:** Kryesues, e kemi praktikuar edhe për hera tjera që raportet të shqyrtohen të gjithë përnjëherë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Atëherë a jeni raportet nga 7-14, të shqyrtohen të gjitha përnjëherë? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Prezent 25. Në këto pikë ishte prezent edhe Betim Shala.

Mua personalisht raportet po me duken shumë të mangëta në kuptimin e përmbajtjes, sepse janë bërë gati të njëjta për të gjitha, ndërkaq në realitet dallojnë shumë. Ne e dimë që në vitin e kaluar kemi pasur edhe marrje të pronës të operatorëve që nuk iu kanë përmbajtur kontratës. Në bazë të këtyre raporteve, e shoh se ka operator ekonomik që nuk janë duke investuar në përputhje me planin që e kanë ofruar. Është mirë që këto të reflektojnë në raporte, ne gjithëherë iu kemi dhënë prioritet veprimtarive prodhuese, që është edhe kriter për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale, të cilët pastaj zhvillojnë konkurrencë jo lojale në raport me operatorët tjerë ekonomik. Duhet të kërkonin nga komisioni me paraqitur gjendjen reale faktike, të operatorëve që kanë investuar në pronën komunale. Nëse është e nevojshme, për ata që kanë dalë jashtë planit, të merren masa me herët, se pastaj po bëhet edhe me keq për me iu marrë prona, sepse kur të vjen puna, duhet të veprojmë për të gjithë njësoj, e mos të vjen puna që të investojnë për ndonjë veprimtari tjetër. E hapi diskutimin për pikët 7-14:

7. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik "MUJA" O.P;
8. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik "JLG CONSTRUCTION" SH.P.K;
9. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik N.P "X- PLAST";
10. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik "NTP GREEN PRODUCT";
11. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik "XHEMILE VISHI.B.I";
12. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik N.SH.T "LYPETENI";

13. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik Fatmir Gashi B.I.;

14. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik "ERA PLAST SH. P. K".

**z. Selajdin Troni:** I kam përcjellë këto si komision, shumica prej tyre e kanë filluar veprimtarinë, ndërkaq shqetësuese është çështja e punëtorëve se nuk po mundën me gjetur. Tjetra, të ndërrimi i destinimit të veprimtarisë, nuk po e përmendi me emra, por çështja është se ka operatorë ekonomik që ka filluar veprimtarinë, por e ka ndryshuar, shtuar ndonjë veprimtari tjetër, e që kujtoj se nuk është ndonjë shqetësim, nuk e shoh problematike që krahas aktivitetit primar, e shton edhe një veprimtari tjetër sekondare. Fabrikat që kanë filluar, shihet se janë në përfundim e sipër, kështu nuk e shoh ndonjë problem, veç mos të del krejt prej rrjedhave, për ndryshe në rregull është.

**znj. Ardita Rrahmani:** Jemi duke diskutuar në pako, si raporte janë të varfër, janë paraqitur disa foto dhe numri i punëtorëve, krahasuar me ato të 6 mujorit me parë, nuk është se ka ndonjë ndryshim. Shpresoj mos të përsëriten njëjtë edhe në fund të vitit. Suksese për veprimtarinë.

**z. Agim Mani:** Raportet janë shabllon për të gjitha, nuk ka specifika për secilën veç. Raportet që janë sjellë, nuk mundemi të quajmë raport të një prone që është dhënë në shfrytëzim dhe kur dihet se çka duhet të përmbajë një raport. Raportet që i kemi janë të thata, pa analiza, pa të dhëna konkrete dhe pa asnjë vlerësim për përmbajtje reale që ka pasur obligim ekzekutivi ti mbikëqyrë këto prona të dhënies në shfrytëzim, ku është interesi i komunës dhe qytetarëve tanë. Keni sjellë një raport shabllon për të gjitha pronat që janë dhënë në shfrytëzim, pavarësisht se secila pronë ka specifikat e veta dhe faza të ndryshme dhe në këtë formë është e pamundur të kuptojmë ecurinë e këtyre pronave që janë dhënë në shfrytëzim. Unë mendoj se raportet duhet të kalohen në këtë formë, pa e ditur ecurinë dhe zhvillimin e punimeve, duhet të kërkohet llogari për secilën pronë veç e veç. Kryetari nuk është këtu, ndërkaq është obligim me raportuar në KK. Kërkoj nga kryetari të na njoftoj me detajesh rreth ecurisë së këtyre pronave. Është e pamundur me kuptuar raportet vetëm me këto të dhëna, por besoj që kryetari ka mbikëqyrje të drejtpërdrejtë dhe informacione veç e veç për secilën pronë të dhënë në shfrytëzim. Po të ishte kryetari këtu, do ia parashtroj pyetje, por po ia parashtroj nënkryetarit apo DUKMM çfarë konkretisht ka fituar komuna ekonomikisht dhe financiarisht për këto prona që janë dhënë në shfrytëzim, sa të hyra janë inkasuar në buxhet. Kështu e thotë ligji për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale në shfrytëzim, se për këtë qëllim janë dhënë në shfrytëzim. Sa është realizuar plani dinamik? A është realizuar investimet e planit investim apo projektit ideor, siç e keni quajtur që janë premtuar me këto prona dhe kush i ka vërtetuar këto. Është absurde ku në secilin projekt është projekti ideor. Projektet ideore bëhen qysh në sot me një procedurë, sepse ideja mundet të ndryshon, projekti nuk ndryshon. Në përshkrimin e tyre që thuhet bazuar në projektin ideor, që është absurde, duhet me u bazuar në projektin detal, se projekti ideor mundet me ndryshuar dhe ka ndryshuar. Në një pronë ka aplikuar për rrobaqepësi, ndërkaq prodhon dyer dhe dritare, sepse kjo është ideja. Kur të kesh projekt, kjo nuk mundet me ndryshuar. Cila është mbikëqyrja e juaj si ekzekutiv, për tu siguruar se këto prona menaxhohen në përputhje me qëllimin publik? A është bërë ndonjë kontratë apo vlerësim i pavarur që me ndikuar në ekonominë e komunës? Këto raporte nuk mjafton vetëm të jenë përshkrime formale, ato duhet të paraqesin një pasqyrë reale të menaxhimit të pasurisë publike me përgjegjësi dhe transparencë. Nëse nuk dihet çka është përfituar nga dhënia në shfrytëzim e pronës publike, atëherë nuk dihet për çka i japim. Kërkoj nga kryetari dhe ekzekutivi që për hera tjera të sjellin raporte të plota me analiza të qarta dhe me përgjigje për qytetarin që presin një menaxhim me të mirë të pronave të dhëna në shfrytëzim.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Në ankand që del për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim, kërkohet plani i biznesit, dhe plan dinamik për realizimin e atij plani. Në planin e biznesit duhet

me u caktuar qartë se, cilat janë mënyrat që ata kanë me financua. E shoh që thonë se kanë dështuar si lëmi, sepse në planin e biznesit bëhet edhe skot analiza e cila e bënë rrishtun dhe nëse ato i kanë paraparë rrishtun, se nëse mendojnë se nuk i funksionon ajo veprimtari me zhvilluar veprimtari tjetër, ajo është shkelle e ligjit, përndryshe nëse nuk i funksionon plani i biznesit, duhet me ardhur me dorëzuar në komunë.

**z. Selajdin Troni:** Nëse një investitor e kam marrë pronën për zhvillimin e veprimtarisë së rrobaqepësisë, këtu po shihet se i ka angazhuar 7 punëtorë, ne nuk e di se a kemi të drejtë me shikuar si kontrata se a janë duke punuar 7 punëtorë apo jo, ndoshta komisioni për këto duhet me na njoftuar në raport. Nuk e di ne sa mundemi me i besuar vetëm se është shkruar në raport, nuk e di sa kemi të drejtë ne me i shikuar kontratat. Sa po i shohim këto raporte me foto, ne e shohim se veç kanë filluar punimet. Tjetra, po e themi, nëse e kanë bërë një plan biznesi, se Agim, pronat nuk epën në shfrytëzim pa e pasur planin e biznesit, ndërkaq e zhvillon edhe një veprimtari tjetër aty, unë nuk e shoh si pengesë, ndërkaq nëse ia ndërron komplet destinimin siç na ka ndodhur dhe jemi detyruar me ia marrë pronën, atëherë ne duhet me vepruar. Ndërkaq përderisa është duke e zhvilluar projektin në bazë të planit, ndërkaq e ka shtuar edhe një veprimtari tjetër, unë kisha thënë të vazhdojnë të punojnë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Veprimtaria dytësore, nuk duhet me kaluar veprimtarinë parësore, dhe veprimtaria që e zhvillon aktivitetin, duhet të dëshmohet me fakte, ai biznes sa ka realizuar qarkullim brenda vitit, se kemi kompani që po deklarojnë me fatura, sa ka shitur jashtë sa brenda, sa punëtorë i ka shtuar dhe po kemi kompani që nuk ka bërë asgjë dhe vlerësimi jepet i njëjtë, pjesërisht të realizuar planin dinamik, dhe i trajtojmë njëjtë. Mendoj se këtu duhet me bërë dallim, ne e dini që nuk kemi dhënë pronë për derivate, ndërkaq po ndërtohet. Unë jam duke folur për ata që e mbikëqyrin punën, ose për një Elkos apo Viva, sa shitore duhet me u mbyllur në atë rajon apo sa ekonomi familjare, për me realizuar një dikën që nuk ka nevojë hiq me pasur. Ti kemi parasysh këto çështje, a po i bëjmë dem apo po i bëjmë mirë. Ne i kemi nisur për qëllimin me të mirë, jo për me bërë dem. Mos të shuajmë konkurrencën me të vogël që është aty.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Për këto raporte nuk po kemi çka me diskutuar se me të vërtetë janë raporte të mangëta. Po me intereson me ditur për çështjen e konfiskimit të pronës nga betonjerka. A mundeni me sjellë ndonjë raport për atë çështje, e di se u ndalë puna, por çka ka me ndodhur me pronën dhe ato mjetet që janë aty. Janë dy prona në Kaçanik të Vjetër, ajo që iu ka dhënë betonjerkës dhe një pronë të hekurudha. Po me intereson çka ka me ndodhur me pronën dhe pajisjet.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ne si Kuvend i Komunës pronën ia kemi kthyer komunës, ndërkaq ajo tjetra është e lirë.

**znj. Ernesta Krasniqi:** E lirë është, por e ka njëfarë temeli.

**z. Agim Mani:** Unë ju referova punës së komisionit se unë e di prej ankandit publik se çka duhet me pasur, planin e biznesit, projektin ideor, se e vërtetë është se nuk mundesh me bërë një projekt të tillë, pa e ditur a e fiton apo jo, për atë duhet me pasur një projekt ideor. Me 13.06.2025, komisioni ka dalë në vendngjarje dhe është absurde në këtë datë të kërkohet projekt ideor, sepse projekti i detajuar ti përcakton fazat se në cilën fazë është biznesi, fillestare, të mesme apo përfundimtare. Nëse kërkon projekt ideor, nuk ka mundur me punuar kurrë, se ideja ndryshon çdo ditë. Komisioni këtë duhet me kërkuar komisioni, që kur të shkon në inspektim, fillimisht të kërkohet projekti i detajuar, pastaj me shikuar punimet se në cilën fazë janë.

**z. Qamil Stagova:** Pajtohem që raporti i komisionit me qenë me në detal, është më mirë. Të dhënat që janë shkruar, nuk janë paushall, komisioni ka dal të secili vend dhe i ka marrë të dhënat nga terreni. Aty ku u përmend projekti ideor, krahasimi, secila firmë në shprehje të biznesit apo ankand, ka konkurruar edhe me plan ideor. Komisioni ka bërë krahasim në atë projekt, çka kanë realizuar sot dhe kanë ardhur në përfundim se është përmbushur pjesërisht,

se asnjëra firmë nuk i ka plotësuar krejt kushtet, në bazë të cilave iu ka dhënë vendi. Përfitimet e komunës, pronat nuk janë dhënë në formë të qirasë. Komuna nuk merr para prej këtyre firmave. Përfitimet mundën me qenë: numri i të punësuarve, lejet e ndërtimit -janë përfitime financiare, tatimi në pronë, pasi të ndërtohet objekti, hyjnë në pagesa të TP. Nuk i kam shënimet këtu se cilat kanë hyrë në pagesë të TP cilat jo.

**Kryesuesi i Kuvendit:** A ka paguar leje ndërtimi “Muja OP”?

**z. Qamil Stagova:** “Muja OP” ka paguar leje ndërtimi, ka diçka dënime prej asaj leje ndërtimi.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Për punë të derivateve duhet leje e veçantë, se kjo shkon me sasi të lejes së derivateve. Po me intereson, a e ka marrë lejen në komunë?

**z. Qamil Stagova:** Jo nuk e ka.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nëse nuk e ka, pse është lejuar me ndërtuar?

**z. Qamil Stagova:** Nuk e di se tjetër kush e ka mbikëqyrjen.

**z. Agim Mani:** Unë e potencova me herët, para se me filluar punimet, biznesi që ka qenë përfitues, është dashur me ardhur në komunë me dorëzuar projektin dhe me punuar në bazë të projektit të detajuar. Mirëpo komisioni i cili ka dalë në vendngjarje, nuk është profesional. Këtu duhet me vepruar ne, që komisioni me qenë profesional, që me kërkuar llogari prej secilit biznes, se në këtë formë iu ndihmojmë bizneseve. Nëse shkojmë në këtë formë, këta kanë me shkuar paushall dhe në fund ku me i ardhur puna sikur atij me herët që i ka ardhur. A doni me iu qëndruar përkrah bizneseve, duhet me iu qëndruar paralel me atë që kërkohet me ligj dhe me i përkrahur.

**Nënkryetari i Komunës:** Meqë është e drejtë ekskluzive e kryetarit raportimet për dhënien e pronave në shfrytëzim, po mundohem në pika të shkurtra me dhënë sqarime. E para, na gëzon faktin që janë 8 kompani që iu kanë dhënë prona në shfrytëzim nga 2019-2024. Pajtohem me sugjerimet e juaja që raporti është me i mangët, është dashur raportet të jenë me të mira, këtë e marrim si vërejtje dhe sugjerime të juaja të arsyeshme. Në vitin 2019 kompanitë kanë pasur pak probleme në realizim, se ishte vit pandemie, hera tjera kur të japim prona në shfrytëzim, duhet pasur parasysh edhe afatet për pajisje të lejes nga KEDS, shumica e kompanive iu shkon 1 vit thonë derisa të marrin pëlqimin në KEDS dhe lejet hapësinore. Ka shumë elemente që ndikojnë, e mira e asaj është se komuna përfiton se e rritë numrin e të punësuarve, pagesa e TP, lejet e ndërtimit qysh e potencoj edhe drejtori. Unë personalisht mendoj se nga ne duhet me kërkuar se, a ka zbatim në përputhje me planin që e kanë, se normal që secili konkurren me projekt ideor, por në moment që i jepet në shfrytëzim prona nga organi përkatës, më nuk shkon me projekt ideor, por me projekt detal. Projekti ideor është sa me konkurruar për atë pronë dhe a shihni ju të arsyeshme apo jo, nëse e merr, e sjell projektin detal. E jona është me kërkuar zbatimin e projektit detal. Kaçaniku ka pak prona komunale, nëse kompania del kundër kriterëve ligjore, është një elementi që iu jep hapësirë edhe pronave tjera që i kanë në shfrytëzim, që nëse keni konkurruar me atë logjikën vetëm sa me marrë pronën në shfrytëzim, dhe nuk përmbushin kriteret për realizimin e planit detal, rrezikohet me iu marrë prona. Parimisht as ne as ju nuk jeni me ua marrë pronën në nga shfrytëzimi, por nëse punojnë në kundërshtim me planin detal, rrezikojnë me iu marrë prona. Edhe ne edhe ju jemi për atë që me sjellë sa me shumë projekte nga ndonjë kompani gjigante. Po ndërlidhem me kompaninë që iu ka marrë prona, prona iu ka marrë me KK, iu ka vendosur shiriti për me i hequr pajisjet, përndryshe vetëm nëse ka ndonjë afat shtesë për heqjen e pajisjeve, se afatet kanë përfundua edhe afati shtesë që ka qenë ka përfunduar. Pronës iu kanë vendosur shiritat, nëse prehen shiritat, është vepër penale. Për mjetet duhet me gjetur ndonjë formë, se nuk është bash e lehtë kjo se është një kompani gjigante, por tash shiritat janë vendosur, afat tjetër nuk ka, vetëm nëse

me ndonjë kërkesë apo sugjerim, kërkojnë me i lejuar me i hequr mjetet, atëherë duhet me shikuar anën ligjore se a kemi të drejtë apo jo me iu dhënë, përndryshe janë vendosur shiritat dhe nuk ka me afat.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Të këto raporte, nuk munda me pa raportimin për Arsi Cola. Ndoshta është në fillim, po e themi se bash këtu, komisioni ka pasur çka me shkruar, se është një investim gjigant që është duke ndodhur. Shtohet pyetja, ai që e ka qëllimin e vërtetë me realizuar, ky i fundit e ka marrë pronën, por ka investuar sa krejt këto tjerat me i bërë bashkë, po e bëjmë krahasimin të investitorët serioz, dihet puna në start.

**z. Qamil Stagova:** Arsi Cola dhe kompania që e ka marrë pronën në shfrytëzim, janë në start, në fazën fillestare, për atë nuk është raportuar për këto dy kompani.

**znj. Ardita Rrahmani:** Ne prapë po kthehemi të ajo që komisioni nuk e ka bërë punën si duhet, e na ka lënë hapësirë për me debatuar rreth asaj pike. Komisioni është ekskluzivisht për atë punë, vetëm ti kishte paraqitur çështjet në formë konkrete, se nëse është vetëm me shkruar me i realizuar disa fotografi, diku 2 e diku 10, kishim shkruar secili. Nëse raportimi do ishte në rregull, komisioni nuk ka faj sa punon operatori. Komisioni ka faj që nuk e sjellë raportin me të detajuar ndaj atij biznesi. Raporti është shabllon një fletë me foto diku me shumë e diku me pak. Drejtor, ndoshta do ishte mirë nga ana juaj si përgjegjës, me kërkuar nga komisioni që me qenë më vigjilent në përmbushjen e detyrave.

**z. Qamil Stagova:** Besoj se komisioni e ka kontrolluar punën e operatorëve ekonomik. Nëse flasim për numrin e punëtorëve, janë dhënë të dhënat, ju a po kërkon me ditur se a janë krejt punëtorët me letra, se ne duhet me punuar pak edhe me mirëbesim, unë atij komisioni i besoj.

**znj. Ardita Rrahmani:** Drejtor, në besim edhe ju ka dhënë prona operatorëve ekonomik. KK i ka besuar biznesit që ia ka dhënë në shfrytëzim pronën. E vetmja hapësirë ku ne duhet me i besuar investitorit, është se ai ka me zbatuar planin e tij.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Unë nuk kam nevojë me i besuar asnjë komisioni, se ajo kompani që ka paraqitur këtë numër të punëtorëve, me hyrë në ATK e shohim se a i ka apo jo. Nuk ka nevojë për mirëbesim këtu. Asnjë kompani nuk ka të drejtë me prezantuar numrin e punëtorëve, pa i pasur, se është shkelje ligjore, është vepër penale. Cilido prej neve mundet me vërtetuar se a është ky numër i punëtorëve. Sa i përket numrit të punëtorëve, unë fillimisht e potencova se krejt kompanitë kanë problem me numër të punëtorëve, duke qenë pjesë e menaxhmentit në sektorin privat, e di që sot numri i punëtorëve është problem, kështu që nuk mund ti bëjë fajtor për këtë, por ka plot elemente tjera që mundem me u lidhur.

**z. Besnik Salihu:** Desha me pyetur drejtorin, qysh veprohet në rastin kur një operator ekonomik gjatë rrugës e ndërron krejt destinimin e prodhimit, nga tekstili në prodhim të dyerve dhe dritareve? Mendoj se nuk i lejohet komplet ndërrimi i destinimit të prodhimit. Me intereson me ditur, ligjërisht qysh veprohet, nëse kompania e ndërron veprimtarinë?

**z. Qamil Stagova:** Për veprimtarinë që iu ka dhënë prona, nëse nuk ka punuar hiq, duhet me ia ndërprerë punën. Përndryshe duhet me shikuar, se as vet nuk e di qysh duhet.

**z. Besnik Salihu:** Sa e di unë, përpos veprimtarisë, e ka ndërruar edhe emrin, se nuk e ka veprimtarinë qysh kanë ardhur letrat në komision, se unë atëherë kam qenë pjesë e komisionit.

**z. Qamil Stagova:** Mos është fjala për Vogliqin?

**z. Besnik Salihu:** Po. E kam fjalën qysh është ligjërisht e rregulluar kjo çështje, se nuk kam ndonjë iniciative, se me mirë është me qenë një fabrikë aty sesa si ka qenë përpara. E potencoj edhe nënkryetari se ne e kemi krijuar një situatë në Kaçanik të Vjetër dhe e kemi dhënë një

shembull, që nëse veprojnë operatorët tjerë ekonomik, e dinë tjerët sesi veprohet. Anën tjetër drejtor, nuk e di, se a e dinë se mundesh me aplikuar me një emër tjetër, me një projekt tjetër, dhe rrugës mundesh me ndryshuar me punuar diçka tjetër? Nëse nuk gabo, aty kanë qenë 25 punëtorë, dinamika ashtu ka qenë që me u punësuar në fillim, ani pse janë 7 punëtorë, tani ka ndryshuar teknologjia dhe i zëvendëson punëtorët, se jo që ka mungesë të punëtorëve, por teknologjia i zëvendëson, por me ndërruar komplet emrin, me ndërruar komplet veprimtarinë, për mendimin tim, ligjërisht nuk i lejohet, se paku duhet me ardhur edhe njëherë lënda në KK.

**Nënkryetari i Komunës:** Një sqarim për Agimin. Sa i përket aspektit financiar, nëse e keni fjalën për komplet qarkullimin, shitjen që e bënë kompania, në tregun e jashtëm apo të brendshëm, ne si komunë kemi diskutuar edhe me herët, numrin e punëtorëve, lejet e ndërtimit, tatimi në pronë, tatimi në qarkullim, këtu ka edhe biznesmen që e dinë që direkt kanë punë me ATK, ATK pastaj i dërgon në nivel qendror, ndërkaq ato prapë i kthehen qytetarit në përputhje me numrin e punëtorëve. Sa i përket tatimit në qarkullim, krejt e dinë krejt kush ka biznes që ato mjete nuk shkojnë në buxhetin e komunës, por në buxhetin e nivelit të Kosovës, ata i bëjnë ato inspektimet pastaj dhe varësisht prej qarkullimit dhe shkon buxheti. Të ajo tjetra, nganjëherë kur të evolon, kur të ndryshon teknologjia, duhet me bërë kërkesë dhe ta kthen përgjigjen, nëse nuk lejohet, duhet me shkuar përmes KK.

**z. Besnik Salihu:** Nuk po dua me më kthyer përgjigje, vetëm ta ketë parasysh për veti, se ashtu kështu tani jemi në fund të mandatit.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Sa i përket kësaj çështje, me shumë problem iu paraqet këtyre, për shkak të krimeve ekonomike, zyrtarëve ju vjen puna a po e merr apo shkon. Për mos me ardhur puna deri aty, as ata nuk i lëmë me u dëmtuar me tepër, dikush me dërguar një ankesë, dihet çka del, kështu të jemi syçelë sa me herët.

**z. Agim Mani:** Pasi me përmendi emrin nënkryetari, po e marrë fjalën. Unë isha shumë i qartë, cili është përfitimi financiar dhe ekonomik i komunë? Kështu e thotë ligji i dhënies së pronës në shfrytëzim, që komuna përfiton financiarisht dhe ekonomikisht. Çka ka përfituar komuna financiarisht dhe ekonomikisht? Ekonomikisht po dihet, numri i punëtorëve i cili nuk është arritur, ndërkaq, financiarisht nuk ka përfituar asgjë. Cilat kanë qenë të hyrat e dhënies në shfrytëzim të pronës së komunës, në buxhetin e komunës?

**Nënkryetari i Komunës:** Prona nuk është dhënë me qira, por në shfrytëzim.

**z. Qamil Stagova:** Kur kemi marrë vendim me ua dhënë në shfrytëzim pronat komunale, firmave, është e vërtetë që LVV ka kërkuar me ua dhënë me interes financiar. Ky KK nuk e ka miratuar. Kjo formë që janë dhënë nuk është e paligjshme.

**z. Agim Mani:** Nuk e kam thënë unë, por ligji e thotë ashtu, komuna përfiton ekonomikisht dhe financiarisht.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Duke u nisur nga hapi i parë që aplikon një biznes në komunë, të gjitha taksat komunale ka me i kryer, nëse ka obligime, ka me i shlyer. Ka me sjellë garancinë që nuk është në hetime. Prej fillimit të lejes së ndërtimit, komuna rrjedhjen me të madhe të HVK e ka nga lejet e ndërtimit, që fatkeqësisht na kanë munguar me të madhe. Aty përfiton financiarisht, ato taksa i kemi caktuar ne, ndërkaq nuk e di sesa përfiton, se në bazë të m2, paguhet taksa për leje të ndërtimit. Pos kësaj, ajo hapësirë hynë në TP, që për biznese është me e lartë sesa të ekonomitë familjare. Taksat për biznese i kemi liruar, ndërkaq obligimet tjera financiare shkojnë në buxhetin e Kosovës, që përmes grantit specifik, kthehen të komuna. Çështja ekonomike, ndërtohet infrastruktura, ai vend merr pamje tjetër ku investohet, rritet vlera e pronës dhe e pronave private që janë për rreth aty. Numri i të punësuarve, është në stagnim,

shpresoj kjo të rregullohet në të ardhmen, sepse edhe për biznesin është leverdi me pasur punëtorë, për me i shkuar puna me mirë dhe mbarë.

**z. Agim Mani:** Kryesues, unë thashë, a keni bërë ndonjë analizë ju, a ia vlen me i dhënë pronat komunale në shfrytëzim apo jo? Ju e dini që për një fabrikë të lëngjeve, janë dhënë mbi 3.5 ha. Cili është përfitimi i komunës në këtë rast?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Është investim gjigant, nuk ka biznes me serioz, se ky operator. Vetëm objektin që e ka nisur, e ka në sipërfaqe mbi 1 ha, plus investimet që vazhdon. Ai synon me pasur biznes të madh, shpresoj t'i ecë. Ai vlerën e investimeve e ka të madhe. Të ky operator, nuk jam pishman, të disa tjerë po, se ky operator në fillim është duke treguar se është serioz dhe është duke investuar. Shtohet pyetja: Çka ka përfituar komuna nga ajo pronë që 25 vjet, e cila pronë ka qenë djerrinë?

**z. Agim Mani:** Unë prapë se prapë fajin po ia lë komisionit, se komisioni duhet me qenë profesional dhe me i ndihmuar bizneset, mirëpo bizneset nuk ndihmohen në këtë formë. E vërteta është se, dhënia në shfrytëzim që është marrë në vitin e kaluar, ka arritur shkallën e zhvillimit me të lartë, mirëpo ndoshta para 4 viteve ka pasur një ndërprerje të mungesës gjatë rrugës, siç e përmendi nënkryetari, çështjen e rrymës, mirëpo lë të paraqitet si raport, se prej kësaj dite ka pasur mungesë me rrymë dhe nuk ka pasur mundësi me i zhvilluar punimet. Ne atëherë pajtohemi me atë raport, duke ditur problemet që ka pasur kompania me rrymë, apo është çështje e neglizhimit të punëve.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Ne e shterëm këtu debatin, të gjithë u deklaruan se këtu është mangësi e punës së komisionit. Komisioni a është i formuar nga kryetari i komunës apo nga drejtoria? Çka ndodhë tash, ne po e dimë se ky komision nuk ka sjellë raport të mirë në KK, që me na bërë të qartë ecurinë e punës se bizneseve? A është faji të komisioni dhe cilat dhe objektivat, hapat e mëtutjeshëm, mos ti bien përsëri këso raporte të mangëta, e me fol ne krejt për të njëjtën çështje, e mos me marrë asnjë iniciativë për punën dhe përgjegjësinë që e ka marrë komisioni? A është në kompetenca të kryetarit apo të drejtorisë ky komision, hapat e mëtutjeshme ndaj komisionit, a duhet me vazhduar tutje punën ky komision? Ndoshta nuk është kompetenca tona me fol, por duhet ti ndajmë gjërat, çështja e komisionit, a është në kompetenca të kryetarit apo të drejtorisë?

**z. Qamil Stagova:** Çdo herë pas periudhës 6 mujore, formohet komision i ri.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Komisioni duhet me u vetëdijesuar dhe me marrë me përgjegjësi punën, sepse ndihmon në gjitha aspektet, edhe neve si KK edhe bizneseve.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Komisioni ka menduar se i ka përfshirë në raporte të gjitha, me vërejtjet tona, tani e tutje duhet të jetë me i kujdesshëm.

**Nënkryetari i Komunës:** Punën e komisionit ne nuk mundemi me lëshuar në zero,

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, konstatohet se Kuvendi i Komunës

## NJOFTOHET

**Me raportet për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, për ofertuesit ekonomik si vijon:**

7. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik "MUJA" O.P/Lënda: 01Nr. 104/02-13420/25;
8. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik "JLG CONSTRUCTION" SH.P.K/Lënda: 01Nr. 104/02-13420/25;
9. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik N.P "X-PLAST"/Lënda: 01Nr. 104/02-13452/25;
10. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik "NTP GREEN PRODUCT"/Lënda: 01Nr. 104/02-13456/25;
11. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik "XHEMILE VISHI.B.I"/Lënda: 01Nr. 104/02-13426/25;
12. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik N.SH.T "LYPETENI"/Lënda: 01Nr. 104/02-13445/25;
13. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik Fatmir Gashi B.I./Lënda: 01Nr. 104/02-13433/25;
14. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik "ERA PLAST SH. P. K"/Lënda:01Nr. 104/02-13347/25.

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, Kryesuesi e konstatoj mbledhjen të përfunduar në ora 13:18. Nga 26 anëtarë të KK sa ishin pjesëmarrës në këtë mbledhje, deri në fund të mbledhjes qëndruan 25 anëtarë. Anëtari Raif Kasa doli nga mbledhja gjatë diskutimit të pikës 2.


Procesmbajtës

Makfire Malsiu

*Malsiu*

Kryesues i Kuvendit

Kemal Murseli



*Kemal Murseli*